



Ministria e Punëve të Brendshme  
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova  
Ministry of Internal Affairs

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /  
GOVERNMENT OF KOSOVA

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE




Inspektorati Policor i Kosovës  
Policijski Inspektorat Kosova  
Police Inspectorate of Kosovo

---

*Raport Inspektimi Nr: 7/2015*

## INSPEKTIMI I PROCESIT TË GRADIMIT NË POLICINË E KOSOVËS



(2015)

Aprovuar  
Fitim Shishani  
Kryeshef Ekzekutiv i IPK-së

---

## SHKURTESAT

|              |   |
|--------------|---|
| <i>IPK</i>   | <i>Inspektorati Policor i Kosovës</i>                       |
| <i>PK</i>    | <i>Policia e Kosovës</i>                                    |
| <i>DPP</i>   | <i>Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës</i>       |
| <i>DBNJ</i>  | <i>Departamenti për Burime Njerëzore</i>                    |
| <i>DZHPK</i> | <i>Drejtoria për Zhvillim të Performancës dhe Karrierës</i> |
| <i>UA</i>    | <i>Udhëzim Administrativ</i>                                |
| <i>PSO</i>   | <i>Procedura Standarde e Operimit</i>                       |
| <i>NJPP</i>  | <i>Njësia për Përkrahje të Personelit</i>                   |

# P Ë R M B A J T J A

|   |         |
|---|---------|
| 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....  | (4-6)   |
| 2. HYRJE.....   | (7-8)   |
| 3. PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE .....   | (9-13)  |
| 3.1. Vlerësimi i respektimit të infrastrukturës ligjore që rregullon çështjen e zhvillimit në<br>karrierë- procesin e gradimit..... | (9-13)  |
| 4. TË GJETURAT GRADA MAJOR.....   | (14-15) |
| 4.1. Faza e Aplikimit.....  | (14)    |
| 4.2. Test- Zgjidhja e skenarëve.....  | (14)    |
| 4.3. Test -Intervista me gojë.....  | (14-15) |
| 5. TË GJETURAT GRADA KAPITEN.....   | (16-18) |
| 5.1. Faza e Aplikimit.....  | (16)    |
| 5.2. Test- Zgjidhja e skenarëve.....  | (16-17) |
| 5.3. Test -Intervista me gojë.....  | (17-18) |
| 6. TË GJETURAT GRADA TOGER.....   | (19-20) |
| 6.1. Faza e Aplikimit.....  | (19)    |
| 6.2. Testi me shkrim.....   | (19)    |
| 6.3. Test- Zgjidhja e skenarëve.....  | (20)    |
| 6.4. Test -Intervista me gojë.....  | (20)    |
| 7. TË GJETURAT GRADA RRESHTER.....  | (21-25) |
| 7.1. Faza e Aplikimit.....  | (21)    |
| 7.2. Testi me shkrim.....   | (21-22) |
| 7.3. Test- Zgjidhja e skenarëve.....  | (22-23) |
| 7.4. Test -Intervista me gojë.....  | (23-25) |
| 8. PËRFUNDIMET.....   | (26)    |
| 9. REKOMANDIMET.....  | (27)    |
| 10. PLANI I VEPRIMIT TË PK-së PËR PËRMBUSHJEN E REKOMANDIMEVE TË IPK-<br>së.....  | (28)    |

## 1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1.1 Në bazë të nenit 24, paragrafi 2, të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), IPK-ja ka zhvilluar një inspektim të jashtëzakonshëm në Departamentin për Burime Njerëzore në fushën inspektuese “Inspektimi i Procesit të Gradimit”. Me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së, ky inspektim është zhvilluar për të vlerësuar respektimin e infrastrukturës ligjore që rregullon çështjen e zhvillimit në karrierë-procesin e gradimit në PK.

1.2 Inspektimit në këtë fushë i ka paraprirë, hartimi i programit inspektues duke përfshirë edhe përzgjedhjen e metodologjisë së punës. Programi inspektues ka paraparë fillimin e aktivitetit inspektues në terren më datë 19.05.2015, si dhe është zhvilluar në bazë të protokollit zyrtar të inspektimit.

1.3 Inspektimi në Departamentin për Burime Njerëzore është shtruar si nevojë për tu siguruar që procesi i gradimit në PK është organizuar konform nevojave për plotësimin strukturor dhe funksional të organizatës, verifikuar respektimin e infrastrukturës ligjore që rregullon fushën e procesit të gradimit si dhe për tu vërtetuar që të dhënat e shënuara gjatë këtij procesi kanë qenë të sakta dhe në përputhshmëri me rezultatet e publikuara.

1.4 Të gjeturat e inspektimit tregojnë se PK pas analizimit të nevojave për plotësimin e personelit me grada kishte organizuar dhe përmbyllur procesin e gradimit për Nënkolonel, Major, Kapiten, Toger dhe Rreshter. Në të gjitha proceset graduese PK kishte themeluar komisionet dhe panelet vlerësuese në përputhje me procedurat e parapara ligjore, përveç në njërin nga proceset konkretisht tek procesi i gradimit për Toger. Gjatë themelimit të komisionit për procesin e gradimit për gradën Toger ishte caktuar një anëtarë i komisionit, zyrtarë policor nga departamenti që nuk ka mundur të jetë anëtarë i këtij komisioni sipas procedurës ligjore në fuqi.

1.5 Në të gjitha proceset graduese për Major, Kapiten, Toger dhe Rreshter kanë aplikuar gjithsej tremijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë 3479 kandidatë (zyrtarë policor), prej të cilëve në përputhje me aktet ligjore në fuqi, janë diskualifikuar në fazën fillestare shtatë dhjetë e një (71) aplikues, kanë munguar në proceset testuese tetëqind e tetë (808) aplikues, gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë (688) aplikues kanë dështuar në test me shkrim, katër (4) nga ta kanë dhënë dorëheqje nga procesi, gjashtë (6) aplikues janë diskualifikuar nëpër faza të procesit gradues, kanë dështuar në zgjidhjen e problemit sipas skenarëve njëmbëdhjetë (11) aplikues dhe njëqind e dyzetë e tetë (148) aplikues kanë dështuar në intervistë me gojë. Po ashtu në përputhje me bazën ligjore, kandidatë të graduar janë gjashtëqind e gjashtë dhjetë e katër (664) zyrtarë policor, nëntëqind e njëzet e shtatë (927) nga kandidatët janë në pritje për tu graduar, kurse njëqind e pesëdhjetë e dy (152) nuk kanë arritur të gradohen.

1.6 Ndërsa për të gjitha proceset graduese janë parashtruar gjithsej tridhjetë (30) ankesa për të cilat komisionet pas shqyrtimit kanë nxjerrë vendime. Po ashtu janë parashtruar kërkesa të ndryshme e të cilat zakonisht kanë pasur të bëjnë me shtyrjen e datës të intervistës me gojë, si dhe si dhe pjesëmarrjen në procese të gradimit për shkak të vonesave në fazën e aplikimit për të cilat gjithashtu komisionet pas shqyrtimit kanë nxjerrë vendime.

1.7 Njësitë për Përkrahje të Personelit, ku zyrtarët policorë kanë qenë të emëruar brenda datës së fundit të periudhës së aplikimit, kanë pranuar aplikacionet e zyrtarëve policor që kanë aplikuar për proceset graduese ku nga gjithsej tremijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë 3479

aplikacione, IPK ka kontrolluar 1908 aplikacione që kanë kaluar me sukses fazën e aplikimit. Nga 1908 aplikacionet e kontrolluara, 1226 kanë qenë të plotësuara në të gjitha hapësirat e parapara të formularit të aplikacionit ndërsa 682 prej tyre janë pranuar nga njësia e lartcekur duke mos i plotësuar të gjitha hapësirat e parapara në aplikacion siç është paraparë në Udhëzimin Administrativ nr. 08/2012 apo më konkretisht nuk janë plotësuar hapësirat tek pranimit-dorëzimi i formularit të aplikacionit. Duhet theksuar që këto të gjetura nuk kanë ndikuar në procesin e mëtejshme gradues për aplikantët.

1.8 Të gjeturat e përgjithshme tregojnë se në përputhje me bazën ligjore PK-ja ka zhvilluar metodat testuese varësisht se cilat nga gradat ju kanë nënshtruar procesit. Andaj, në fazën e testimi për zgjedhjen e problemit sipas skenarëve të gjeturat e përgjithshme për të gjitha gradat tregojnë saktësi në 98% të llogaritjeve të pikëve, ku gabimet teknike në llogaritje janë identifikuar të jenë tek procesi i gradimit për Kapiten dhe Rreshter. Ndërsa sa i përket të gjeturave si rrethana të veçanta janë identifikuar tri (3) raste me gabime teknike në llogaritje të pikëve tek procesi i gradimit për Kapiten dhe njëzetë e gjashtë (26) raste me gabime teknike në llogaritje të pikëve tek grada Rreshter. Në të gjitha rastet këto gabime teknike në llogaritje nuk kanë ndikuar që dikush të mos promovohet në këtë proces të gradimit.

1.9 Metoda testuese e intervistave me gojë të gjeturat e përgjithshme tregojnë saktësi në llogaritje të pikëve në 97% të saktësisë, ku gabimet në llogaritje janë përcjell tek procesi i gradimit për Kapiten dhe Rreshter. Ndërsa sa i përket të gjeturave si rrethana të veçanta janë identifikuar shtatë (7) raste me gabime në llogaritje të pikëve tek procesi i gradimit për Kapiten dhe dyzetë e pesë (45) raste me gabime në llogaritje të pikëve tek grada Rreshter. Në të gjitha rastet gabimet në llogaritje nuk kanë ndikuar sa i përket promovimit të deritanishëm në procesin e gradimit.

1.10 Sa i përket metodës testuese me shkrim, është vënë në pah se PK, në përputhje me bazën ligjore kishte bërë kontrollimin e testeve me anë të skanerit të cilin e kishte testuar dhe mostrat testuese kishin treguar 100% të saktësisë. Mirëpo IPK gjatë kontrollimit të mostrës prej 215 flet-përgjigjeve për gradën rreshter dhe 529 për gradën toger, ka identifikuar një rast që përputhshmëria në mes të pikëve në flet-përgjigjet e testit me listën përfundimtare të rezultateve të publikuara tek procesi për rreshter nuk ka qenë e njëjtë duke shënuar dhe publikuar dhjetë pikë më pak se sa që kishte si rezultat aplikuesi, dhe në të cilin rast ai do të duhej të ishte graduar. Pas identifikimit të këtij rasti nga IPK-ja, duhet theksuar që PK-ja në përputhje me UA 08/2012, ka ndërmarrë masat e duhura dhe ka arritur që në rastin e identifikuar me numër aplikacioni 05/2112, në të cilin aplikantit ju kanë zbritur dhjetë (10) pikët në listën përfundimtare, ka nxjerrë vendim me të cilin ka shqyrtuar dosjen e zyrtarit policor dhe ka kërkuar që të bëhet ndryshimi i listës përfundimtare për gradën rreshter, si dhe ka obliguar drejtorinë për zhvillim të performancës dhe karrierës që të veproj konform PSO në fuqi me ç'rast drejtoria personelit me datë 10.09.2015, ka nxjerr vendim për gradim në gradën rreshter për aplikantin e lartcekur.

1.11 Lidhur me të gjeturat e paraqitura në këtë raport, IPK me datë 11.09.2015, ka mbajtur edhe takimin përmblyës me menaxhmentin e PK-së të fushës përkatëse. Në këtë takim janë diskutuar të gjitha detajet e paraqitura në raport ku si konkluzion i këtij takimi ka dalë se të gjithë të pranishmit janë pajtuar me këto të gjetura.

1.12 Me datën 25.09.2015 IPK-ja ka pranuar nga Drejtoria për Zhvillim të Karrierës dhe Performacës, Planin e veprimit në realizimin e rekomandimeve, në të cilin është konstatuar se rekomandimet e dhëna do të kihen parasysh gjatë proceseve të ardhshme të gradimit.

## 2. HYRJE

2.1 Bazuar në Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK) është zhvilluar inspektimi i jashtëzakonshëm me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së, lidhur me procesin e gradimit të zhvilluar në PK për konkurset e vitit 2012-2013. Ky inspektim është funksionalizuar nga Departamenti i Inspektimit ku gjatë Inspektimit janë vizituar: Departamenti për Burime Njerëzore, Drejtoria e Personelit dhe Drejtoria për Zhvillim të Performancës dhe Karrierës. Fokusi i inspektimit ka përfshi verifikimin e të dhënave në procesin e gradimit për konkurset me numër të referencës: 07/1-01P/014/2012-Major; 07/1-01P/020/2012-Kapiten; 07/1-02/004/2013-Toger dhe 07/1-02/013/2013-Rreshter.

2.2 Rëndësia e organizimit të këtij inspektimi ka qenë:

- Të vlerësojë se PK-ja ka ndërmarrë të gjitha masat që procesi i gradimit ka rrjedhur në përputhje me bazën ligjore;
- Të vlerësojë që procesi ka qenë objektiv, transparent, i barabartë- jodiskriminues;
- Të verifikojë që të gjitha vlerësimet nga ana e komisioneve dhe paneleve vlerësuese kanë qenë në përputhshmëri me të dhënat e paraqitura.

2.4 Objektivi që do të arrij ky inspektim është:

Vlerësimi i respektimit të infrastrukturës ligjore që rregullon çështjen e zhvillimit në karrierë- Procesin e Gradimit.

2.5 Lloji i Inspektimit: Inspektim i Përputhshmërisë

2.6 Periudha mbuluese e kësaj fushe të inspektimit përfshinë periudhën: 2012-2013.

2.7 Si kriter matës Inspektorati Policor i Kosovës ka marrë:

- Ligji i Policisë,
- UA- 08/2012 Për Procedurën e Gradimit për Zyrtar Policor,
- PSO për gradim në PK Nr. 6.02,
- Doracakut i Parimeve dhe Procedurave, Parimi 3.29.

2.8 Inspektimi është përqendruar në këto drejtime kryesore:

- Baza ligjore që rregullon fushën e gradimeve.
- Saktësia e të dhënave në formularët e vlerësimeve
- Përputhshmëria e të dhënave vlerësuese nga komisionet në raport me bazën e të dhënave

2.9 Metodologjia: Gjatë këtij inspektimi është aplikuar metodologji e kombinuar e punës dhe atë në mes të intervistave me personelin kompetent për zhvillimin e procesit të gradimeve si dhe kontrollimi fizik i dokumentacioneve. Për shpjegime të mëtejme gjatë inspektimit janë kontrolluar të gjitha dokumentet relevante të cilat kanë qenë pjesë e procesit të gradimit duke përfshi: të gjitha dosjet e aplikuesve për gradat Major, Kapiten; për Toger janë kontrolluar 321 dosje të kandidatve të suksesshem dhe të gjitha testet me shkrim nga skeneri dhe; për Rreshter 1440 dosje të aplikantve

të suksesshem ndërsa te testi me shkrim nga skaneri jane kontrolluar 215 flet-përgjigje të testeve. Gjatë kontrollimit të këtyre dosjeve është verifikuar çështja e plotësimit të aplikacionit në të gjitha hapësirat e përcaktuara, saktësia e prezantimit të pikëve në testin me shkrim të paraqitura nga skaneri tek lista përfundimtare, saktësia në llogarije të pikëve në formularët për zgjidhjen e problemit sipas skenarëve, intervistës me gojë, si dhe publikimi i pikëve në listat përfundimtare. Gjithashtu janë evidentuar edhe të gjitha ankesat e pranuar nga aplikantët në këto procese gradimi.



### 3. PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE

#### 3.1 Vlerësimi i respektimit të infrastrukturës ligjore që rregullon çështjen e zhvillimit në karrierë- procesin e gradimit.

3.1.1 Promovimi brenda organizatave policore krijon zhvillime individuale të zyrtarëve policor përmes së cilës mënyrë gjithashtu përfiton edhe organizata duke ndërtuar lehtësime në kryerjen e detyrave të përditshme. Mundësitë për tu promovuar ndryshojnë varësisht infrastrukturën ligjore që rregullojnë çështjet e gradimit në organizatat policore.

3.1.2 Policia e Kosovës ka të ndërtuar mënyrën e promovimit në nivelin e përgjithshëm dhe të standardizuar të organizatës, duke përfillur bazën ligjore e cila është e paraparë që nga Ligji për Policinë (2011/04-L-076), Udhëzimi Administrativ nr. 08/2012 për Procedurën e Gradimit të Zyrtarëve Policor, PSO P-3.29 lidhur me Komisionet për Procesin e Gradimit, si dhe PSO për Gradim nr. 6.02. Referuar infrastrukturës ligjore, zyrtarët policor në sistemin gradues janë të radhitur si në vijim;

- Polic i RI
- Polic
- Polic i Lartë
- Rreshter
- Togër
- Kapiten
- Major
- Nënkolonel dhe
- Kolonel

3.1.3 Me qëllim të zbatimit të infrastrukturës ligjore, PK në strukturën organizative ka të funksionalizuar Departamentin për Burime Njerëzore, në varshmëri strukturore të të cilit janë Drejtoria për Personel dhe Drejtoria për Zhvillim të Performacës dhe Karrierës e cila përveç tjerash është përgjegjëse të verifikojë nëse zyrtarët policor që kanë aplikuar përmbushin kriteret e parapara ligjore, ka ushtruar rolin e ofrimit të ndihmës administrative, logjistike duke shërbyer si sekretariat për komisionet dhe panelet intervistuese.

3.1.4 Si rezultat i standardeve të përcaktuara, PK-ja ka krijuar Komisionet për Procesin e Gradimeve, Panelet Vlerësuese si dhe ka bërë përpilimin e testeve me shkrim, testeve me gojë, testeve në skenar. Zyrtarët Policor që janë përfshirë në procesin e gradimit varësisht nga niveli i gradimit edhe ju kanë nënshtruar metodave të testimit. Varësisht nga metoda testuese është bërë llogaritja përfundimtare e vlerësimit. Kështu që bazuar në UA. 08/2012, testi me shkrim është vlerësuar 60%, intervista me gojë 25% dhe zgjidhje e problemit sipas skenarëve 15%.

3.1.5 Referuar bazës ligjore, Komisionet për procesin e gradimeve janë paraparë që të themelohen me propozim të Drejtorit të DBNJ-ës dhe me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, të cilët janë përbërë nga më së paku tre anëtarë nga të cilët do të përfshiheshin anëtarë të komuniteteve dhe grupeve të pakicave, ku në të gjitha rastet është dashur të bëhet përpjekje që komisionet të kenë baraspeshë gjinore si dhe askush nga DBNJ s'ka mundur me qenë anëtarë i këtyre komisioneve. Secili proces i gradimit ka pasur komisionin përkatës të cilët është dashur të kenë së paku një gradë më të lartë se zyrtarët policorë që ju kanë nënshtruar

procesit të gradimit. Këto komisione kanë qenë përgjegjëse për të siguruar se procesi i gradimit do të zhvillohet në mënyrë transparente, objektive, dhe jo diskriminuese, në pajtim me ligjin, udhëzimin administrativ, dhe akte tjera të brendshme.<sup>1</sup> Mirëpo gjatë këtij procesi të gjeturat tregojnë se është evidentuar një (1) rast<sup>2</sup> ku njëri nga anëtarët e këtij komisioni ka qenë i caktuar nga radhët e punonjësve të departamentit për burime njerëzore.

3.1.6 Ndërsa sa i përket paneleve vlerësuese UA. 08/2012, ka parapa që për të gjitha fazat e testimit të krijohen panelet vlerësuese nga drejtori i DBNJ-së, ku numri i anëtarëve të panelit për secilën fazë të testimit të caktohet sipas nevojave por jo me më pak se tre anëtarë të cilët duhet të jenë për një gradë më të lartë se zyrtarët që i nënshtrohen procesit të testimeve si dhe duhet që të reflektojnë përbërje etnike varësisht nga etnia e zyrtarit që i nënshtrohet procesit të testimeve. Çështjet e paneleve intervistuese janë të precizuara në anekset e PSO nr. 6.02 për gradim sipas të cilave panelet janë përgjegjëse për vlerësim të kandidatit në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë PSO. Vlen të theksohet që në përbërje të këtyre paneleve njëri nga tre anëtarët caktohet si kryesues i panelit për vlerësim i cili njëherit mban dhe përgjegjësinë e përgjithshme për mbarëvajtje të procesit si dhe kujdeset për efikasitetin e procesit<sup>3</sup>.

3.1.7 Fillimisht pas analizimit të nevojave për personel të graduar, DBNJ ka shpallë konkurset për personel të graduar duke filluar nga grada nënkolonel, major, kapiten, toger dhe rreshter, ku në përputhje me UA 08/2012, ka paraparë që koha e përfundimit të këtij procesi të jetë brenda një afati optimal. Ndërsa zyrtarët policor të cilët kanë dashur që të marrin pjesë në procesin e gradimit kanë aplikuar pranë Njësisë për Përkrahjen e Personelit ku ata kanë qenë të emëruar, brenda datës së fundit të periudhës së aplikimit.<sup>4</sup>

3.1.8 Referuar të dhënave nga dokumentacionet e siguruar, është vënë në pah se PK-së duke përfillur procedurat e parapara ligjore ka arritur që të organizojë procesin e gradimit për gradat Nënkolonel, Major, Kapiten, Toger dhe Rreshter. Në bazë të Udhëzimit Administrativ 08/2012, grada nënkolonel parasheh si metodë testimi vetëm vlerësimin në performacën vjetore për dy vitet e fundit dhe intervista ekzekutive gjë që si rrjedhojë IPK nuk ka trajtuar fare konkursin e shpallur për nënkolonel. Sa i përket procesit të gradimit për Major dhe Kapiten metoda e testimit ka paraparë që të ketë testime në zgjidhje të problemit sipas skenarëve dhe intervista me gojë derisa për gradat Toger dhe Rreshter parasheh metodën e testimit me shkrim, intervistë me gojë dhe zgjidhje të problemit sipas skenarëve.

3.1.9 Duhet theksuar se IPK ka kontrolluar 1908 aplikacionet që ju kanë nënshtuar fazave testuese me qëllim që të verifikojë respektimin e procedurës ligjore në fazën e aplikimit si dhe si rezultat i metodave të testimit të verifikojë dokumentacionet për të gjitha nivelet e gradimit varësisht se si ka paraparë baza ligjore metodat testuese. Për më tutje janë kontrolluar formularët e intervistave me gojë, dhe zgjedhjes së problemit sipas skenarëve duke verifikuar saktësinë tek llogaritjet në formularët e testeve. Ndërsa në testet me shkrim, që aplikohet vetëm për gradat toger dhe rreshter, janë verifikuar përputhshmëria në mes të dhënave të paraqitura me skaner në fletpërgjigje si dhe rezultateve të publikuara në listën finale.

3.1.10 Sa i përket kontrollimit të testeve me shkrim IPK ka arritur që të kontrollojë numrin e

<sup>1</sup> UA nr. 08/2012 neni 4 Komisionet për Procesin e Gradimeve.

<sup>2</sup> Vendimi me nr. 1236 për Themelimin e Komisionit për procesin e gradimit –Toger

<sup>3</sup> PSO-6.02 për Gradim në Policinë e Kosovës

<sup>4</sup> UA nr. 08/2012 neni 9 Faza e Aplikimit

përgjithshëm të formularëve për gradën toger (529 flet pergjigje). Ndërsa për shkak që procesi i gradimit për gradën rreshter ka qenë i fundit me radhë dhe ka përfshi një numër të madh të aplikuesve, PK edhe gjatë fazës së inspektorët kanë qenë në inspektim, ka punuar në drejtim të përmblylljes së punëve administrative. Andaj, si rezultat i kësaj gjendje IPK tek testet me shkrim për gradën rreshter ka kontrolluar në mënyrë të rastësishme një numër të konsiderueshëm të flet-pergjigjeve apo më saktësisht 215 prej tyre.

3.1.11 Të gjeturat e përgjithshme tregojnë që procesi i gradimit për gradën major, kapiten, toger dhe rreshter ka përfshi një numër të konsiderueshëm të aplikantëve numri i të cilëve gjatë fazave ka pësuar ndryshime (ulje të numrit të aplikantëve) si rezultat i çështjeve të parapara ligjore, procese të cilat janë të paraqitura në formë tabelore si më poshtë.

| <b>Tabela nr. 1</b> | Numri i aplikuesve | Diskualifikuar në fazën fillestare | Diskualifikuar gjatë fazave testuese | Aplikantë që kanë munguar gjatë procesit | Dëshuar Skenarë | Dëshuar Intervista me gojë | Dëshuar Testi me shkrim | Aplikantë që kanë dhënë dorëheqje | Aplikant në pritje për tu graduar | Aplikantë të graduar | Aplikantë të pa Graduar |
|---------------------|--------------------|------------------------------------|--------------------------------------|--|-----------------|----------------------------|-------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|----------------------|-------------------------|
| <b>Major</b>        | 43                 | 1                                  | 0                                    | 0  | 2               | 3                          | /                       | 1                                 | 1                                 | 35                   | /                       |
| <b>Kapiten</b>      | 105                | 6                                  | 2                                    | 0  | 2               | 2                          | /                       | 3                                 | 0                                 | 90                   | /                       |
| <b>Toger</b>        | 579                | 11                                 | 0                                    | 44                                       | 0               | 17                         | 187                     | 0                                 | /                                 | 168                  | 152                     |
| <b>Rreshter</b>     | 2752               | 53                                 | 4                                    | 764                                      | 7               | 126                        | 501                     | /                                 | 926                               | 371                  | /                       |
| <b>Gjithsej</b>     | 3479               | 71                                 | 6                                    | 808                                      | 11              | 148                        | 688                     | 4                                 | 927                               | 664                  | 152                     |

3.1.12 Ndërsa varësisht se cili nga proceset graduese është zhvilluar inspektorët kanë kontrolluar dosjet fizike për dyzet e dy (42) major, njëqind e pesë (105) kapiten, për Toger janë kontrolluar 321 dosje të kandidatëve të suksesshëm dhe; për Rreshter 1440 dosje të aplikantve të suksesshëm. Kështu që në numër të përgjithshëm ka përfshi njëmijë e nëntëqind e tetë (1908) aplikues të cilët ju kanë nënshtruar procesit të kontrollimit të dosjeve fizike.

3.1.13 Në fazën e aplikimit zyrtarët të cilët kanë shpreh gatishmërinë për të qenë pjesë e procesit të gradimit kanë dorëzuar aplikacionet e tyre në Njësinë për Përkrahje të Personelit ku ata kanë qenë të emëruar, brenda datës së fundit të aplikimit. Inspektimi ka vënë në pah që nga gjithsej 1908 aplikacione të kontrolluara në të gjitha nivelet e organizatës njëmijë e dyqind e njëzet e gjashtë (1226) apo 64% prej tyre kanë përfillur standardin për plotësimin e të gjitha hapësirave si kritere që janë përcaktuar në formularin e aplikacionit deri sa gjashtëqind e tetëdhjetë e dy (682) prej tyre apo 36% e numrit të përgjithshëm janë dorëzuar në Njësitë për Përkrahje ku zyrtarët policor kanë qenë të emëruar, Njësinë për Përkrahje të personelit në DPP si dhe në DZHPK-ës duke mos plotësuar të gjitha hapësirat e parapara në formularë konkretisht në hapësirën për Shënimet e Pranim-Dorëzimi i Aplikacionit. Në tabelën në vijim pasqyrohen të gjeturat sa i përket aplikacioneve të plotësuar në të gjitha hapësirat dhe aplikacioneve që nuk janë plotësuar në të gjitha hapësirat.

| <b>Tabela. Nr. 2</b> <i>Plotësimi i Aplikacionit</i> |   |  |    |  |    |
|--|---|--|----|--|----|
| Gradat   | Gjithsej aplikacione të kontrolluara <sup>5</sup> | Aplikacione të plotësuara në të gjitha hapësirat | %  | Aplikacionet jo të plotësuara në të gjitha hapësirat | %  |
| <b>Major</b>   | 42  | 21   | 50 | 21   | 50 |
| <b>Kapiten</b>                                       | 105   | 46   | 44 | 59   | 56 |
| <b>Toger</b>   | 321   | 207  | 65 | 114  | 35 |
| <b>Rreshter</b>                                      | 1440  | 952  | 66 | 488  | 34 |
| <b>Gjithsej</b>                                      | 1908  | 1226   | 64 | 682  | 36 |

3.1.14 Sa i përket të gjeturave për testimin e zgjidhjes së problemit sipas skenarëve të gjeturat e përgjithshme tregojnë se saktësia në llogaritje është 98%. Kështu që llogaritje 100% të sakta ka rezultuar të ketë procesi i gradimit tek grada Major dhe Toger. Kurse në procesin për gradim Kapiten dhe Rreshter procesi ka rezultuar të përfshijë gabime në llogaritje nga ana e ndonjërit prej anëtarëve të panelit vlerësues. Në tabelën në vijim pasqyrohen të gjeturat sa i përket formularëve për zgjedhjen e problemit sipas skenarëve me llogaritje të sakta dhe atyre me llogaritje jo të sakta

| <b>Tabela. Nr. 3</b> <i>Vlerësimet në formularët e për zgjedhjen e skenarëve</i> |   |                                  |     |                                    |   |
|--|---|----------------------------------|-----|------------------------------------|---|
| Gradat   | Gjithsej formularë të kontrolluara <sup>6</sup> | Formularë me llogaritje të sakta | %   | Fomularë me llogaritje jo të sakta | % |
| <b>Major</b>   | 42  | 42                               | 100 | 0                                  | 0 |
| <b>Kapiten</b>   | 105   | 102                              | 97  | 3                                  | 3 |
| <b>Toger</b>   | 321   | 321                              | 100 | 0                                  | 0 |
| <b>Rreshter</b>  | 1440  | 1414                             | 98  | 26                                 | 2 |
| <b>Gjithsej</b>  | 1908  | 1879                             | 98  | 29                                 | 2 |

3.1.15 Procesi i cili ka përfshi metodën e testimit të intervistës me gojë është përcjell me 97% të saktësisë së përgjithshme. Saktësi 100% në llogaritje ka rezultuar të kenë pasur procesi i gradimit tek grada Major dhe Toger. Ndërsa në procesin e gradimit për Kapiten dhe Rreshter procesi ka rezultuar të ketë gabime në llogaritje nga ana e ndonjërit prej anëtarëve të panelit vlerësues. Në tabelën në vijim pasqyrohen të gjeturat sa i përket formularëve për intervistën me gojë në llogaritje të sakta dhe atyre me llogaritje jo të sakta.

| <b>Tabela. Nr. 4</b> <i>Vlerësimet në formularët e intervistimit me gojë</i> |   |                                  |     |                                    |   |
|--|---|----------------------------------|-----|------------------------------------|---|
| Gradat   | Gjithsej formularë të kontrolluara <sup>7</sup> | Formularë me llogaritje të sakta | %   | Fomularë me llogaritje jo të sakta | % |
| <b>Major</b>   | 42  | 42                               | 100 | 0                                  | 0 |
| <b>Kapiten</b>   | 105   | 98                               | 94  | 7                                  | 6 |
| <b>Toger</b>   | 321   | 321                              | 100 | 0                                  | 0 |
| <b>Rreshter</b>  | 1440  | 1395                             | 96  | 45                                 | 4 |
| <b>Gjithsej</b>  | 1908  | 1856                             | 97  | 52                                 | 3 |

<sup>5</sup> Të dhëna të siguruar nga DPZHPK

<sup>6</sup> Të dhëna të siguruar nga DPZHPK

<sup>7</sup> Të dhëna të siguruar nga DPZHPK

3.1.16 Testi me shkrim në procesin për toger dhe rreshter të gjeturat e përgjithshme tregojnë se në procesin toger rezultatet e testeve janë prezantuar në listat përfundimtare me 100% saktësi, kurse tek procesi për rreshter është identifikuar një (1) rast i cili nuk ka qenë në përputhshmëri në mes të pikëve të shënuara nga skaneri dhe listës së rezultateve përfundimtare (nr. dosjes 05/2112).

3.1.17 Në përputhje me rregullat e përcaktuara ligjore kandidatët kanë pasur të drejtën e parashtrimit të ankesës. Kështu që në proceset graduese, Major janë parashtruar tri (3) ankesa, Kapiten gjashtë (6) ankesa, Togër tetë (8) ankesa dhe Rreshter trembëdhjetë (13) ankesa, me ç'rast Komisionet dhe Drejtori i Departamentin për Burime Njerëzore kanë shqyrtuar këto ankesa dhe kanë marrë vendime. Në tabelën në vijim pasqyrohet procesi i parashtrimit të ankesës për secilën gradë në raport me numrin e ankesave, aprovimin dhe refuzimin e tyre.

| <b>Tabela 5</b> |                | <b>Parashtrimi i Ankesës</b> |                   |
|-----------------|----------------|------------------------------|-------------------|
| <b>Grada</b>    | Numri ankesave | Vendimet                     |                   |
|                 |                | Ankesë e Aprovuar            | Ankesë e Refuzuar |
| <b>Major</b>    | 3              | 0                            | 3                 |
| <b>Kapiten</b>  | 6              | 1                            | 5                 |
| <b>Togër</b>    | 8              | 1                            | 7                 |
| <b>Rreshter</b> | 13             | 1                            | 12                |
| <b>Gjithsej</b> | 30             | 3                            | 27                |

3.1.18 Duhet theksuar që gjatë këtyre proceseve përveç ankesave, zyrtarët policor kanë parashtruar dhe kërkesa të ndryshme e të cilat zakonisht kanë pasur të bëjnë me shtyrjen e datës të intervistës me gojë<sup>8</sup>, si dhe pjesëmarrjen në procese të gradimit për shkak të vonesave në fazën e aplikimit<sup>9</sup>, ku për secilin rast komisionet kanë nxjerrë vendime.

<sup>8</sup> Vendim i Komisionit, 29.01.2014, 13.02.2014, 06.02.2014, 27.01.2014, 27.01.2014, 27.01.2014, 27.01.2014, 12.02.2014, 27.01.2014, 27.01.2014, 27.01.2014, 12.02.2014, 10.02.2014.

<sup>9</sup> Vendim i Komisionit 31.07.2013, 02.08.2013.

## 4. TË GJETURAT GRADA-MAJOR

### 4.1 Faza e Aplikimit

4.1.1 Në fazën e aplikimit zyrtarët të cilët kanë shpreh gatishmërinë për të qenë pjesë e procesit të gradimit kanë dorëzuar aplikacionet e tyre në NJPP ku ata kanë qenë të emëruar, brenda datës së fundit të aplikimit. Nga gjithsej dyzetë e tre (43) aplikues, njëri (1) nga ta është diskualifikuar nga DSP e cila ka autoritetin për diskualifikim<sup>10</sup>. Andaj, procesit testues ju kanë nënshtruar dyzetë e dy (42) aplikantë, ku inspektimi ka vënë në pah se nga gjithsej dyzetë e dy (42) aplikacione të kontrolluara, 21 nga to janë pranuar si aplikacione të plotësuar në mënyrë të rregullt, deri sa njëzetë e një (21) tjera janë pranuar si të pa plotësuar në të gjitha hapësirat e parapara të formularit. Hapësirat e identifikuar të cilat zakonisht nuk janë plotësuar kanë pasur të bëjnë me pikën gjashtë të aplikacionit tek Shënimet për Pranim-Dorëzimin e Aplikacionit në të cilën hapësirë kërkohen shënimet për emrin, mbiemrin, datën e pranimit, nënshkrimin e aplikuesit si dhe të zyrtarit sektorit të resurseve. Po ashtu janë identifikuar raste kur nuk është përfillur procedura për ti dhënë kopjen e pranim-dorëzimit zyrtarit i cili ka aplikuar si dhe disa nga aplikacionet nuk kanë pasur shënime lidhur me numrin e aplikacionit. (Shih tabelën nr. 6).

| <b>Tabela. Nr. 6</b> <i>Plotësimi i Aplikacionit</i> |  |   |    |   |    |
|--|--|---|----|---|----|
| Gradat   | Gjithsej aplikacione të kontrolluara <sup>11</sup> | Aplikacione të plotësuar në të gjitha hapësirat | %  | Aplikacionet jo të plotësuar në të gjitha hapësirat | %  |
| <b>Major</b>   | 42   | 21  | 50 | 21  | 50 |

### 4.2 Testi - Zgjidhja e skenarëve

4.2.1 Procesi i gradimit për Major në testin e zgjidhjes së problemit sipas skenarëve gjithsej tek dyzetë e dy (42) formularët e kontrolluar kanë qenë të llogaritur në mënyrë të saktë apo kanë rezultuar të kenë 100% saktësi. Kështu që anëtarët e paneleve vlerësuese kanë llogaritur me saktësi të gjitha pikët vlerësuese në formularët për zgjidhjen e problemit sipas skenarëve të secilit aplikantë. (Shih tabelën nr. 7).

| <b>Tabela. Nr. 7</b> <i>Vlerësimet në formularët e për zgjedhjen e skenarëve</i> |   |                                  |     |                                     |   |
|--|---|----------------------------------|-----|-------------------------------------|---|
| Gradat   | Gjithsej formularë të kontrolluar <sup>12</sup> | Formularë me llogaritje të sakta | %   | Formularë me llogaritje jo të sakta | % |
| <b>Major</b>   | 42  | 42                               | 100 | 0                                   | 0 |

4.2.2 Vlen të theksohet që gjatë këtij procesi testues dy (2) nga aplikantët kanë dështuar duke mos arritur pikët minimale të kalueshmërisë (70%)<sup>13</sup> prej një faze në fazën tjetër të procesit të gradimit.

<sup>10</sup> UA nr. 08/2012 për Procedurën e Gradimit për Zyrtarët Policor neni 10 Kriteret e Diskualifikimit

<sup>11</sup> Të dhëna të siguruar nga DPZHPK

<sup>12</sup> Të dhëna të siguruar nga DPZHPK

<sup>13</sup> Shpallja e procesit të gradimit për gradën Major nr.reference 07/1-01P/014/2012.

### 4.3 Testi- Intervista me gojë

4.3.1 Po ashtu në metodën e testimit tek intervista me gojë gjithsej tek dyzetë e dy (42) formularët e kontrolluar kanë qenë të llogaritur në 100% saktësi, sipas të cilave anëtarët e paneleve vlerësuese kanë llogaritur të sakta pikët e shënuara vlerësuese. (Shih tabelën nr. 8).

| Gradat       | Gjithsej formularë të kontrolluar <sup>14</sup> | Formularë me llogaritje të sakta | %   | Formularë me llogaritje jo të sakta | % |
|--------------|---|----------------------------------|-----|-------------------------------------|---|
| <b>Major</b> | 42  | 42                               | 100 | 0                                   | 0 |

4.3.2 Vlen të theksohet që gjatë këtij procesi testues tre (3) nga aplikantët kanë dështuar duke mos arritur pikët minimale të kalueshmërisë (70%)<sup>15</sup> prej një faze në fazën tjetër të procesit të gradimit.

4.3.3 Në përputhje më bazën ligjore pas çdo faze të testimit si dhe në fazën e aplikimit çdo zyrtarë policor ka pasur të drejtën që të parashtrori ankesë pranë Komisionit për procesin e gradimit dhe Drejtorit të Departamentit për Burime Njerëzore<sup>16</sup>, me ç' rast nga tri (3) ankesat e parashtruara, për dy (2) raste Komisioni ka nxjerrë Vendime për Ankesën<sup>17</sup>, kurse për ankesën tjetër pala ankuese ka marrë përgjigjen nga Drejtoria për Zhvillim të Performacës dhe Karrierës<sup>18</sup>.

<sup>14</sup> Të dhëna të siguruar nga DZHPK

